



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes, Financimit dhe Monitorimit

Data	
Nr.	Prot.

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 13, DATË 6.4.2021, TË KOMISIONIT RREGULLATOR “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR RAPORTIMIN FINANCIAR TË SUBJEKTEVE ZGJEDHORE, KONTROLLIN DHE VERIFIKIMIN E FINANCIMEVE DHE SHPENZIMEVE TË TYRE GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE”

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Neni 20, pika 1, shkronja “F”, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ka parashikuar kompetencën e Komisionit Rregullator për të nxjerrë rregullat për raportimin financiar të subjekteve zgjedhore, rolin dhe përgjegjësitë e financierëve të subjekteve zgjedhore, monitorimin dhe auditimin e pavarur të tyre, si dhe për hetimin administrativ të informacioneve, kërkesave, propozimeve, ankesave apo denoncimeve për shkeljet lidhur me financimin apo shpenzimet e fushatës.

Neni 63, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton se subjekti zgjedhor është një parti politike ose një koalicion partish politike, të cilët paraqesin listë kandidatësh, si dhe mund të jetë edhe një shtetas shqiptar me të drejtë vote, i cili propozohet si kandidat për deputet nga një grup zgjedhësish.

Neni 92/1 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon financimin e subjekteve zgjedhore nga fondet jopublike, kufizimet e dhurimeve që çdo person juridik apo fizik vendas mund t’i japë një subjekti zgjedhor, si dhe ndalimet e fondeve nga një person juridik apo çdo aksionar i tij nëse ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit sipas përcaktimeve në Kodin Zgjedhor.

Nenet 92/2 dhe 92/3 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktojnë regjistrimin e fondeve jopublike nga çdo subjekt zgjedhor, të cilët duhet të regjistrojnë në një regjistër të posaçëm, të miratuar me Vendim të KQZ-së, shumën e fondeve të përfutura për çdo person fizik apo juridik, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me identifikimin e qartë të dhuruesit, huadhënësit apo kredidhënësit, nënshkrimin e deklaratës, e cila nënshkruhet në çastin e dhurimit, si dhe deklarimi dhe publikimi i raportit financiar për fushatën zgjedhore që çdo subjekt zgjedhor është i detyruar të paraqesë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve brenda 60 ditëve nga shpallja e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.

Neni 92/6 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton auditimin e fondeve dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore për çdo parti politike të regjistruar si subjekt zgjedhor apo kandidatët e propozuar nga zgjedhësit jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve nga ekspertë kontabël të licencuar dhe të përzgjedhur nga KQZ-ja.

Në zbatim të neneve 20, pika 1, shkronja “f”, 92/1, 92/2, 92/3 dhe 92/6 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, është hartuar projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 13, datë 6.4.2021, të Komisionit Rregullator “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore”.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objektit që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionit Rregullator për ta shqyrtuar.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Hartimi i këtij projektvendimi erdhi si nevojë për të reflektuar ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor si dhe për të përshtatur raportimin financiar online në Platformën Elektronike të Raportimit Financiar.

Risitë në këtë projektvendim janë:

- Shtojca për bilancin e aseteve dhe detyrimeve të partisë politike për periudhën nga dekretimi i datës së zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve. Raporti financiar për fushatë zgjedhore i subjektit zgjedhor përmban informacion të hollësishëm për bilancin e aseteve dhe detyrimeve për periudhën nga dekretimi i datës së zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve, sipas shtojcës nr. 8, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
- Raportimi financiar online për fushatën zgjedhore nga subjektet zgjedhore nëpërmjet Platformës Elektronike të Raportimit Financiar. Ndërveprimi në këtë platformë mundëson/krijon një mundësi shumë të mirë për administrim të plotë dhe të saktë të të dhënave të raportuara për të ardhurat dhe shpenzimet e subjekteve zgjedhore. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u mundëson subjekteve zgjedhore dorëzimin e raporteve financiare të fushatës zgjedhore edhe nëpërmjet Platformës Elektronike të Raportimit Financiar (PERF), e cila gjendet në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, www.kqz.gov.al. Plotësimi dhe dorëzimi i raportit financiar të fushatës zgjedhore nëpërmjet Platformës Elektronike të Raportimit Financiar bëhet sipas procedurave të parashikuara në aktin përkatës të miratuar nga KQZ-ja.
- Audituesi ligjor i dorëzon projekt-raportin e auditimit subjektit zgjedhor, të cilit i jepet mundësia për t’u njohur paraprakisht me gjetjet nga auditimi i pasqyrave financiare dhe për t’ju përgjigjur me observacione ose materiale shtesë, audituesit ligjor për të pasur një raport auditimi përfundimtar sa më të plotë duke pasqyruar situatën reale financiare. Format i standardizuar i projekt-raportit të auditimit përmban gjetje dhe rekomandime përkatëse sipas shtojcës nr. 7, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
- Përgjegjësitë e financierit të partisë politike për monitorimin e tejkalimit të dhurimeve sipas nenit 92/2, pikat 4 e Kodit Zgjedhor, i ndryshuar: - kontrollon të gjitha shpenzimet e bëra nga një subjekt zgjedhor pa përfshirë kandidatët e tij, për fushatën zgjedhore, duke

vlerësuar mostejkalimin e kufirit të shpenzimeve i cili nuk duhet të jetë më shumë se 5 herë më i madh se shuma më e lartë që ka marrë një subjekt zgjedhor nga fondet publike për qëllime zgjedhore.

- Detyrimi dhe përgjegjësia e dorëzimit të raportit financiar për kandidatët e listave shumemërore. Kandidati i listës shumemërore ka detyrimin të informojë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e zgjedhjeve financiarin e partisë politike/financierin e partisë udhëheqëse të koalicionit, mbi të ardhurat dhe shpenzimet e kryera gjatë fushatës.
- Rregullat dhe mënyra e raportimit nga kandidatët e propozuar nga zgjedhësit. Kandidati i propozuar nga zgjedhësit dokumenton dhe regjistron vlerat e fondeve të përfituara nga çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me identifikimin e dhuruesit, huadhënësit ose kredidhënësit sipas modeleve që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Për sa më lart, në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i propozon Komisionit Rregullator, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, shqyrtimin dhe miratimin e projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 13, datë 6.4.2021, të Komisionit Rregullator “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore”.

Licela VELIU

- Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes, Financimit dhe Monitorimit

Pavlina DOÇAJ

- Drejtoria e Ligjshmërisë

Majlinda ÇELMETA

- Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

Tiranë më

protdate

Nr.

protnumber

Data: DD MM VVVV

Nr:000-000

Ora: HH:MM

VENDIM

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 13, DATË 6.4.2021, TË
KOMISIONIT RREGULLATOR “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR
RAPORTIMIN FINANCIAR TË SUBJEKTEVE ZGJEDHORE, KONTROLLIN DHE
VERIFIKIMIN E FINANCIMEVE DHE SHPENZIMEVE TË TYRE GJATË FUSHATËS
ZGJEDHORE”**

Në mbështetje të neneve 20, pika 1, shkronja “f”, 92/1, 92/2, 92/3, 92/6, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S:

- I. Në vendimin nr. 13, datë 6.4.2021, të Komisionit Rregullator “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në nenin 3, pas pikës 1, shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Raporti financiar për fushatë zgjedhore i subjektit zgjedhor përmban informacion të hollësishëm për bilancin e aseteve dhe detyrimeve për periudhën nga dekretimi i datës së zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve, sipas shtojcës nr. 8, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Në nenin 3, pas pikës 2, shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u mundëson subjekteve zgjedhore dorëzimin e raporteve financiare të fushatës zgjedhore edhe nëpërmjet Platformës Elektronike të

Data: dd mmvvvv Nr: 123-456
Ora: hh:mm



“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 13, datë 6.4.2021, të Komisionit Rregullator “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore”

Raportimit Financiar (PERF), e cila gjendet në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, www.kqz.gov.al. Plotësimi dhe dorëzimi i raportit financiar të fushatës zgjedhore nëpërmjet Platformës Elektronike të Raportimit Financiar bëhet sipas procedurave të parashikuara në aktin përkatës të miratuar nga KQZ-ja.

3. Në nenin 5, pas pikës 1, shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Audituesi ligjor i dorëzon projekt-raportin e auditimit subjektit zgjedhor, të cilit i jepet mundësia për t’u njohur paraprakisht me gjetjet nga auditimi i pasqyrave financiare dhe për t’ju përgjigjur me observacione ose materiale shtesë, audituesit ligjor për të pasur një raport auditimi përfundimtar sa më të plotë duke pasqyruar situatën reale financiare. Formati i standardizuar i projekt-raportit të auditimit përmban gjetje dhe rekomandime përkatëse sipas shtojcës nr. 7, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Në nenin 5, pika 2, ndryshohet shtojca nr. 4, sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Në nenin 6, pika 2, shkronja “b”, ndryshohet shtojca nr. 5, sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Pika 7 e nenit 8 ndryshohet si vijon:

“7. kontrollon të gjitha shpenzimet e bëra nga një subjekt zgjedhor pa përfshirë kandidatët e tij, për fushatën zgjedhore, duke vlerësuar mostejkalimin e kufirit të shpenzimeve i cili nuk duhet të jetë më shumë se 5 herë më i madh se shuma më e lartë që ka marrë një subjekt zgjedhor nga fondet publike për qëllime zgjedhore.”.

7. Në nenin 8, pika 8, ndryshohet shtojca nr. 6, sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi.

8. Pika 2 e nenit 9, ndryshohet si vijon:

“2. Kandidati i listës shumemërore ka detyrimin të dorëzojë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e zgjedhjeve, raportin financiar të fushatës të financieri i partisë politike/financieri i partisë udhëheqëse të koalicionit.

9. Pas pikës 2, të nenit 9, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Kandidati i propozuar nga zgjedhësit dokumenton dhe regjistron vlerat e fondeve të përfituara nga çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me identifikimin e dhuruesit, huadhënësit ose kredidhënësit, sipas shtojcës nr. 3 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

- II. Ngarkohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.
III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
IV. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, brenda (5) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Ilirjana NANO Kryetar

Data: dd mmvvvNr: 123-456
Ora: hh:mm



“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 13, datë 6.4.2021, të Komisionit Rregullator “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore”

Arens ÇELA **Anëtar**
Dritan ÇAKA **Anëtar**
Helga VUKAJ **Anëtar**
Muharrem ÇAKAJ **Anëtar**





RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË FUSHATËS ZGJEDHORE _____
PËR SUBJEKTIN ZGJEDHOR _____

**I) TË DHËNAT E
AUDITUESIT**

- | | | | |
|----------------|-------------------------|-----------------|----------------------|
| 1. | <input type="text"/> | 2. Datëlindja | <input type="text"/> |
| | (Emër, Atësia, Mbiemër) | | (dd/mm/vvvv) |
| 3. Adresa | <input type="text"/> | | |
| 4. Tel/Cel | <input type="text"/> | 5. Email | <input type="text"/> |
| 6. Nr. Vendimi | <input type="text"/> | 7. Datë vendimi | <input type="text"/> |

**I) TË DHËNAT E
SUBJEKTIT ZGJEDHOR**

- | | | | |
|-------------|----------------------|----------------------|----------------------|
| 1. Subjekti | <input type="text"/> | 2. Shkronjat nistore | <input type="text"/> |
| 3. Kryetari | <input type="text"/> | 4. Selia | <input type="text"/> |
| | (Emër, Mbiemër) | | |
| 5. NIPT | <input type="text"/> | 6. Financieri | <input type="text"/> |
| | | | (Emër, Mbiemër) |

Emër Mbiemër _____

Firma

Firma _____

Data

Data _____



I. TË DHËNAT E LLOGARARISË BANKARE TË POSAÇME PËR FUSHATËN ZGJEDHORE

	Evidenca e hapjes së llogarisë/ve bankare të posaçme (data/dokumenti bankar)	
	Emri i bankës	
	Adresa e zyrës së bankës	
	Numri i telefonit të zyrës së bankës	
	Adresa e email-it të zyrës së bankës apo zyrtarit përgjegjës të bankës	
	Numri i llogarisë bankare	
	Emrat dhe nënshkrimi i të gjithë personave të autorizuar për veprimet tek llogaria bankare	
	Dokumenti i lëvizjeve bankare (banke statement) që kanë të bëjnë me fushatën zgjedhore	

Emër Mbiemër_____

Firma_____

Data_____



	a) bosh/mungon informacioni	Po / Jo	Çfarë?	
	b) dokumentacioni (shqyrtim i shpejtë)			
		Të Ardhurat		
			Financime publike	
			Donacione private	
			Financim nga burimet e veta të partisë	
			Të ardhurat nga kandidatët e listave shumemeërore	
			Huatë/Kreditë	
		Shpenzimet		
			Mitingje/tubime dhe aktivitete në fushatë	
			Materialet promocionale	
			Media	
			Media Sociale	
			Sondazhe	
			Botime/Publikime	
Shpenzime zyre zgjedhore				
Transporti				
Konsulenca				
Reklamime në natyre				
Shpenzime administrative				
			Shpenzime nga kandidatët e	

Emër Mbiemër_____

Firma_____

Data



			listave shumemeërore	
--	--	--	----------------------	--

Emër Mbiemër_____

Firma_____

Data



II. TË ARDHURAT

A. PËRMBLEDHJE

		Sipas raportit të financimit të fushatës zgjedhore	Sipas auditimit të kryer
1/ Financimi publik			
	Fondi i marrë paradhënie		
	Data e marrjes së fondit		
	Kompensimi financiar paszgjedhor		
	Data e marrjes së kompensimit financiar paszgjedhor		
	Diferenca e kthyer		
	Data e kthimit të diferencës		
2/ Donacionet private			
	Shuma e përgjithshme e raportuar		
	Shuma e donacioneve në para		
	Shuma e donacioneve në natyrë		
	Përgatitet një listë e donatorëve		
	Përfshihen të gjitha dokumentet e lëvizjeve në llogarinë/të bankare të posaçme (bank statement)		
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare të posaçme (bank statement) (shuma)		
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare të posaçme (bank statement) (data)		
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve		

Emër Mbiemër _____

Firma _____

Data _____



	në llogaritë bankare të posaçme (bank statement) (donatori)		
	Përputhshmëria mes çdo donacioni në natyrë të raportuar dhe vlerës së tregut (donatori / data)		
	A përputhen shifrat në total (të përgjithshme)?		
	Respektimi i kufirit të donacionit		
3/ Financimi nga burimet e vetë partisë			
	Shuma e përgjithshme e raportuar		
	Shuma e përgjithshme e raportuar (Zyra Qendrore)		
	<i>Kuotat e anëtarësisë</i>		
	<i>Botimet</i>		
	<i>Shtypi i printuar</i>		
	<i>Shitja e publikimeve</i>		
	<i>Dhënia me qira</i>		
	<i>Interesa bankare</i>		
	<i>Transferte nga llogaritë e partisë</i>		
	Shuma e përgjithshme e raportuar (degët lokale)		
	<i>Botimet</i>		
	<i>Shtypshkronja</i>		
	<i>Dhënia me qera</i>		
	Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogarinë/të bankare të posaçme (bank statement)(shuma)		
	Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogarinë/të bankare të posaçme(bank statement) (data)		
4/ Shuma totale e të ardhurave nga kandidatët e listave shumemërore			
6/ Huatë/Kreditë			
	Shuma e përgjithshme e raportuar		
	Shuma / shuma e huasë / kredisë (për çdo kredi / hua)		

Emër Mbiemër_____

Firma_____

Data_____



	Data e huasë / kredisë dhe data e shlyerjes (për çdo kredi / hua)		
	Paraqitja e dokumenteve mbështetëse (kontratat për secilën kredi / hua)		
5/ Marrja/Arkëtimi i të ardhurave			
	Të gjithë të ardhurat në para të marra / të mbledhura përmes llogarisë specifike.	Po / Jo	

Emër Mbiemër_____

Firma_____

Data_____



A. ANALIZA

a/ Financimi publik

- Shuma dhe data e transferimit të pagesave paradhënie dhe paszgjedhore të marra nga shteti: çfarë ndodh nëse pjesa e caktuar publike që duhet ndarë pas zgjedhjeve nuk është e mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet zgjedhore → që do të thotë se raporti i financimit të fushatës zgjedhore (dhe llogaria bankare) është në defiçit (kundrejt standardeve të kontabilitetit?)
- Kontrolli i minutazhit që subjekti zgjedhor ka marrë nga çdo sektor i medias që siguron kohë të lirë transmetimi.
- Rasti/et e abuzimit/keqpërdorimit të burimeve publike, që janë burimet e siguruar nga shteti, përveç hapësirës së lirë të reklamave dhe kohës së lirë të transmetimit (*do të trajtohen më me hollësi në pjesën e shpenzimeve*).

b/ Financimi nga burimet jo publike

- **Donatorët e lejuar:**
 - o Kontrolli i identitetit të donatorëve dhe lejueshmëria e çdo donacioni të deklaruar;
 - o Kontrolli i shumës së përgjithshme të donacioneve nga i njëjti donator, në veçanti nëse disa donacione janë bërë në nivel qendror dhe nga një degë e partisë;
- **Burimet e palejuara**
- **Kontributet në natyrë**
 - o **Vlerësimi:**
 - Dallimi mes kontributit në natyrë (dhe mundësisht) sponsorizimit dhe veprimtarisë vullnetare;
 - Vlerësimi (rregull i 10% më të ulët se çmimi i tregut apo mallrave/shërbimeve që arrijnë vlerën më shumë se 50,000 Lekë).
 - o **Kufizimet**
 - Kontrolli i shumës së përgjithshme nga i njëjti donator, në veçanti nëse disa donacione janë bërë në nivel qendror nga një degë e partisë;
 - Kufizimet (pragu i raportimit dhe deklarimit zbatohet si për kontributet në para ashtu edhe për ato në natyrë – *si të garantojmë respektimin e kësaj dispozite kur raportet e financimit të fushatës zgjedhore konsolidojnë llogaritë e selisë së partisë me ato të degëve?*)

c/ Financimi nga burimet e vetë partisë politike

- **Klasifikimi sipas zërave i të ardhurave nga burimet e vetë partisë**

Emër Mbiemër _____

Firma _____

Data _____



- ☐ Kuotat e anëtarësisë: shuma e përgjithshme dhe e detajuar sipas shumave të marra
 - ☐ Botimet
 - ☐ Shtypi i printuar
 - ☐ Dhënia me qira
- **Klasifikimi i të ardhurave që merren nga burimet e vetë partisë për secilin zë të deklaruar sipas emrit të degës**
 - ☐ Zyrat Qendrore
 - ☐ Degët lokale
- **Përputhshmëria mes natyrës dhe shumës së të ardhurave të deklaruar dhe deklarimit bankar (bank statement) (mund të përdoret edhe termi “nxjerrje e llogarisë”)**

d/ Huatë/Kreditë

- Identiteti i huadhënësit/ve
- Shuma dhe data e huasë/ve (paraqitja e kontratës së kredisë / huasë).
- Data e shlyerjes e përcaktuar në kontratën e kredisë / huasë/ve (*problemi i huave të fshira— në rast dyshimi, e rëndësishme që të theksohet*)
- Normat e interesit (*llogaritet tek shpenzimet si një shpenzim zgjedhor?*)

Emër Mbiemër_____

Firma_____

Data_____



III. SHPENZIMET

A. PËRMBLEDHJE

Shuma e përgjithshme e raportuar							
Respektimi i kufirit të shpenzimit (Shuma e shpenzimeve nuk duhet të jetë më shumë se 5 herë më e madhe se shuma më e lartë që ka marrë një subjekt zgjedhor nga fondet publike për qëllime zgjedhore, në përputhje me nenin 88 të ligjit nr.10019, datë 19.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar)		Po / Jo					
Shpenzimet e kryera nga Zyra Qendrore e partisë							
	Shpenzimet zgjedhore të deklaruar në raportin e financimit të fushatës zgjedhore	Faturat e paraqitura	Faturat e Përgjithshme	Dokumente mbështetëse që mungojnë	Shpenzime të papaguara	Mospërputhje në lidhje me dokumentet e paraqitura nga furnitorët	Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit
Mitingjet/tubim e dhe aktivitete në fushatë							
Materialet promocionale							
Media							
Media Sociale							
Sondazhe							

Emër Mbiemër _____

Firma _____

Data _____



Botime/Publiki me							
Transporti							
Konsulenca							
Reklamime në natyrë							
Shpenzime zyre zgjedhore							
Shpenzime administrative							
Shpenzimet e bëra nga degët e partisë							
	Shpenzimet zgjedhore të deklaruar në raportin e financimit të fushatës zgjedhore	Faturat e paraqitura	Faturat e Përgjithshme	Dokumente mbështetëse që mungojnë	Shpenzime të papaguara	Mospërputhje në lidhje me dokumentet e paraqitura nga furnitorët	Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit
Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës							
Materialet promovuese							
Media							
Sondazhet e opinionit publik							
Botimet							
Transporti							
Konsulenca							

Emër Mbiemër _____

Firma _____

Data _____



Reklamat në ambientet e jashtme							
Administrative dhe të përgjithshme							
Shpenzimet zgjedhore							
Të gjitha shpenzimet zgjedhore të bëra janë paguar përmes një llogarie të veçantë							Po / Jo
Totali i shpenzimeve të bëra nga kandidatët e listave shumemërore							

Emër Mbiemër_____

Firma_____

Data_____



B. ANALIZA

a/ Respektimi i kufirit të shpenzimeve të fushatës (është çdo shpenzim që bën një parti ose kandidatët e saj për qëllime të fushatë zgjedhore): Për partitë politike **326.456.950** lekë ndërsa për kandidatët e pavarur **32.645.695** lekë → fokusohuni tek “fushatat e shumëfishta” të bëra në nivel qendror dhe degët e partisë në të gjithë vendin;

b/ Analiza e të gjithë shpenzimeve të deklaruar dhe klasifikuara sipas degës së partisë dhe kategorisë, në përputhje me modelin e raportit të financimit të fushatës zgjedhore.

- Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës (fokusohuni tek këto);

- o Shpenzime për vendin/ambjentin;
- o Shpenzimet e zbavitjes/argëtimit;
- o Shpenzimet e pajisjeve;
- o Shpenzimet për pijet;
- o Shpenzimet e reklamave/promocioneve;
- o Shpenzimet e Transportit;
- o Shpenzimet administrative;

- **Materialet promocationale**
- **Media**
- **Media sociale**
- **Sondazhe**
- **Botimet/Publikimet**
- **Transporti**
- **Konsulenca**
- **Reklamime në natyrë**
- **Shpenzime zyre zgjedhore**
- **Shpenzime administrative**

KUJDES: Për secilën kategori të shpenzimeve, analizoni:

- Natyrën zgjedhore të shpenzimeve të llogaritura dhe të përfshira në raportin e financimit të fushatës zgjedhore;

Emër Mbiemër _____

Firma _____

Data _____



- Ekzistencës dhe/ose zbulimit të shpenzimeve të paligjshme (keqpërdorimi i burimeve publike / blerja e votës). Sidoqoftë, këto shpenzime, të paligjshme nga natyra, duhen llogaritur dhe këto shpenzime të llogaritet si tejkalim i kufirit të shpenzimeve.
- Shpenzimeve që janë bërë 6 (gjashtë) muaj para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve duhen llogaritur dhe këto shpenzime si tejkalim i kufirit të shpenzimeve.
- *Raportimi i shpenzimeve në natyrë. Duhet të ekzistojë një përputhshmëri me donacionet në natyrë.*

I. PËRFUNDIMI

A. SINTEZA

- o Përmbledhja e gjetjeve dhe përfundimeve
- o Lista e parregullsive të gjetura gjatë procesit të auditimit
- o Krahasoni me raportin e monitorimit të ekspertit financiarë?

B. PËRFUNDIMI

- o Çertifikimi/dhënia e opinionit pa rezervë
- o Çertifikimi me përmirësime / rezerva/opinionin me rezervë
- o Refuzimi për ta çertifikuar/refuzimi për të dhënë opinion

Opinionin pa rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë tregtare ABC (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 20XX, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, *(ose japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për)*, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 Dhjetor 20XX, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit dhe Kontabilitetit. Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në *[juridiksionin]*, dhe kemi përmbushur

Emër Mbiemër _____

Firma _____

Data _____



përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Opinionit me rezervë (kundërshtues/refuzues)

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë tregtare ABC (shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 20XX, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në seksionin e Bazës për Opinionin me Rezervë të raportit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, (ose japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për) pozicionin financiar të shoqërisë me datën 31 Dhjetor 20XX, dhe performancën financiare e flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin me rezervë

Inventarët e shoqërisë janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në shumën xxx. Drejtimi nuk i ka paraqitur inventarët me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme, por vetëm me kosto, çka përbën një devijim nga kërkesat e SNRF-ve. Regjistrat e shoqërisë tregojnë se nëse drejtimi do t'i kishte paraqitur inventarët me më të ultën midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme, një shumë prej xxx do të paraqitej si pakësim/rënie e vlerës së inventarëve për t'i çuar ato deri në vlerën e tyre neto të realizueshme. Për rrjedhojë, kostot e shitjes do të ishin rritur me xxx dhe tatimi mbi të ardhurat, të ardhurat neto dhe kapitali i aksionarëve do të ishin reduktuar respektivisht me xxx, xxx dhe xxx.

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit dhe Kontabilitetit. Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit të Përgjegjësisë të Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare (të zbatueshme në juridiksionin përkatës) dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë me rezervë.

Emër Mbiemër _____

Firma _____

Data _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

DEKLARATË

Për respektimin e ndalimeve për financimin e subjekteve zgjedhore ose kandidatëve të tyre prej personit fizik/ personit juridik vendas ose çdo ortaku apo aksionar i tij për periudhën 6 (gjashtë) muaj para datës së zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës _____

Neni 92/1

Financimi i subjekteve zgjedhore nga fondet jopublike

3. Ndalohet dhënia e fondeve nga një person juridik apo çdo aksionar i tij nëse ndodhet në një nga kushtet e mëposhtme:

a) ka përfituar fonde publike, kontrata publike apo koncesione në 3 vitet e fundit me vlerë mbi 10 milionë lekë. Ky ndalim zbatohet edhe në rastin e nënkontraktimeve apo të kontratave të partneritetit publik privat;

b) ushtron veprimtari në fushën e medias;

c) ka qenë partner me fonde publike në projekte të ndryshme;

ç) ka detyrime monetare ndaj Buxhetit të Shtetit ose ndaj çdo institucioni publik. Ky detyrim nuk zbatohet nëse aksionari i zotëron këto aksione si rezultat i ofertës publike.

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e personit fizik/personit juridik apo ortak ose aksioner i _____, deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

“Jam i vetëdijshëm për ndalimet e përcaktuara në nenin 92/1 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe deklaroj se nuk jam në asnjë nga rrethanat ndaluese të përcaktuara në dispozitën e mësipërme dhe se fondet janë dhënë prej të ardhurave në pronësinë time”.



Në bazë të nenit 92/2, pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,

AUTORIZOJ:

Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe personat e autorizuar prej tij për të marrë drejtpërdrejt nga banka apo institucionet tjera shtetërore dhe/ose private të dhëna për fondet e dhuruara prej meje; *dhe*

PRANOJ t’i nënshtohem çdo hetimi të thelluar nga institucioni i KQZ-së për të kontrolluar vërtetësinë e këtij dhurimi.

Data e dorëzimit të Deklaratës _____.____.20__

Deklaruesi

(emri, mbiemri, nënshkrimi)

Kjo Deklaratë përbën dokument zyrtar që i drejtohet një organi shtetëror dhe i nënshtrohet hetimit administrativ nga KQZ.

Pasqyrimi i të dhënave të rreme ose të paplota në këtë Deklaratë përbën vepër penale dhe dënohet sipas Kodit Penal.

Trajtimi i të dhënave të deklaruara kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.



PROJEKT-RAPORT I AUDITIMIT TË FUSHATËS ZGJEDHORE _____
PËR SUBJEKTIN ZGJEDHOR _____

**I) TË DHËNAT E
AUDITUESIT**

- | | | | |
|----------------|-------------------------|-----------------|----------------------|
| 1. | <input type="text"/> | 2. Datëlindja | <input type="text"/> |
| | (Emër, Atësia, Mbiemër) | | (dd/mm/vvvv) |
| 3. Adresa | <input type="text"/> | | |
| 4. Tel/Cel | <input type="text"/> | 5. Email | <input type="text"/> |
| 6. Nr. Vendimi | <input type="text"/> | 7. Datë vendimi | <input type="text"/> |

**I) TË DHËNAT E
SUBJEKTIT ZGJEDHOR**

- | | | | |
|-------------|----------------------|----------------------|----------------------|
| 1. Subjekti | <input type="text"/> | 2. Shkronjat nistore | <input type="text"/> |
| 3. Kryetari | <input type="text"/> | 4. Selia | <input type="text"/> |
| | (Emër, Mbiemër) | | |
| 5. NIPT | <input type="text"/> | 6. Financieri | <input type="text"/> |
| | | | (Emër, Mbiemër) |

Emër Mbiemër _____

Firma

Firma _____

Data

Data _____



I. TË DHËNAT E LLOGARARISË BANKARE TË POSAÇME PËR FUSHATËN ZGJEDHORE

	Evidenca e hapjes së llogarisë/ve bankare të posaçme (data/dokumenti bankar)	
	Emri i bankës	
	Adresa e zyrës së bankës	
	Numri i telefonit të zyrës së bankës	
	Adresa e email-it të zyrës së bankës apo zyrtarit përgjegjës të bankës	
	Numri i llogarisë bankare	
	Emrat dhe nënshkrimi i të gjithë personave të autorizuar për veprimet tek llogaria bankare	
	Dokumenti i lëvizjeve bankare (banke statement) që kanë të bëjnë me fushatën zgjedhore	

Emër Mbiemër_____

Firma_____

Data_____



	a) bosh/mungon informacioni	Po / Jo	Çfarë?	
	b) dokumentacioni (shqyrtim i shpejtë)			
		Të Ardhurat		
			Financime publike	
			Donacione private	
			Financim nga burimet e veta të partisë	
			Të ardhurat nga kandidatët e listave shumemeërore	
			Huatë/Kreditë	
		Shpenzimet		
			Mitingje/tubime dhe aktivitete në fushatë	
			Materialet promocionale	
			Media	
			Media Sociale	
			Sondazhe	
			Botime/Publikime	
Shpenzime zyre zgjedhore				
Transporti				
Konsulenca				
Reklamime në natyre				
Shpenzime administrative				
			Shpenzime nga kandidatët e	

Emër Mbiemër_____

Firma_____

Data



			listave shumemeërore	
--	--	--	----------------------	--

Emër Mbiemër_____

Firma_____

Data



II. TË ARDHURAT

A. PËRMBLEDHJE

		Sipas raportit të financimit të fushatës zgjedhore	Sipas auditimit të kryer
1/ Financimi publik			
	Fondi i marrë paradhënie		
	Data e marrjes së fondit		
	Kompensimi financiar paszgjedhor		
	Data e marrjes së kompensimit financiar paszgjedhor		
	Diferenca e kthyer		
	Data e kthimit të diferencës		
2/ Donacionet private			
	Shuma e përgjithshme e raportuar		
	Shuma e donacioneve në para		
	Shuma e donacioneve në natyrë		
	Përgatitet një listë e donatorëve		
	Përfshihen të gjitha dokumentet e lëvizjeve në llogarinë/të bankare të posaçme (bank statement)		
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare të posaçme (bank statement) (shuma)		
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare të posaçme (bank statement) (data)		
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve		

Emër Mbiemër _____

Firma _____

Data _____



	në llogaritë bankare të posaçme (bank statement) (donatori)		
	Përputhshmëria mes çdo donacioni në natyrë të raportuar dhe vlerës së tregut (donatori / data)		
	A përputhen shifrat në total (të përgjithshme)?		
	Respektimi i kufirit të donacionit		
3/ Financimi nga burimet e vetë partisë			
	Shuma e përgjithshme e raportuar		
	Shuma e përgjithshme e raportuar (Zyra Qendrore)		
	<i>Kuotat e anëtarësisë</i>		
	<i>Botimet</i>		
	<i>Shtypi i printuar</i>		
	<i>Shitja e publikimeve</i>		
	<i>Dhënia me qira</i>		
	<i>Interesa bankare</i>		
	<i>Transferte nga llogaritë e partisë</i>		
	Shuma e përgjithshme e raportuar (degët lokale)		
	<i>Botimet</i>		
	<i>Shtypshkronja</i>		
	<i>Dhënia me qera</i>		
	Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogarinë/të bankare të posaçme (bank statement)(shuma)		
	Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogarinë/të bankare të posaçme(bank statement) (data)		
4/ Shuma totale e të ardhurave nga kandidatët e listave shumemërore			
6/ Huatë/Kreditë			
	Shuma e përgjithshme e raportuar		
	Shuma / shuma e huasë / kredisë (për çdo kredi / hua)		

Emër Mbiemër _____

Firma _____

Data _____



	Data e huasë / kredisë dhe data e shlyerjes (për çdo kredi / hua)		
	Paraqitja e dokumenteve mbështetëse (kontratat për secilën kredi / hua)		
5/ Marrja/Arkëtimi i të ardhurave			
	Të gjithë të ardhurat në para të marra / të mbledhura përmes llogarisë specifike.	Po / Jo	

Emër Mbiemër_____

Firma_____

Data_____



A. ANALIZA

a/ Financimi publik

- Shuma dhe data e transferimit të pagesave paradhënie dhe paszgjedhore të marra nga shteti: çfarë ndodh nëse pjesa e caktuar publike që duhet ndarë pas zgjedhjeve nuk është e mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet zgjedhore → që do të thotë se raporti i financimit të fushatës zgjedhore (dhe llogaria bankare) është në defiçit (kundrejt standardeve të kontabilitetit?)
- Kontrolli i minutazhit që subjekti zgjedhor ka marrë nga çdo sektor i medias që siguron kohë të lirë transmetimi.
- Rasti/et e abuzimit/keqpërdorimit të burimeve publike, që janë burimet e siguruara nga shteti, përveç hapësirës së lirë të reklamave dhe kohës së lirë të transmetimit (*do të trajtohen më me hollësi në pjesën e shpenzimeve*).

b/ Financimi nga burimet jo publike

- **Donatorët e lejuar:**
 - o Kontrolli i identitetit të donatorëve dhe lejueshmëria e çdo donacioni të deklaruar;
 - o Kontrolli i shumës së përgjithshme të donacioneve nga i njëjti donator, në veçanti nëse disa donacione janë bërë në nivel qendror dhe nga një degë e partisë;
- **Burimet e palejuara**
- **Kontributet në natyrë**
 - o **Vlerësimi:**
 - Dallimi mes kontributit në natyrë (dhe mundësisht) sponsorizimit dhe veprimtarisë vullnetare;
 - Vlerësimi (rregull i 10% më të ulët se çmimi i tregut apo mallrave/shërbimeve që arrijnë vlerën më shumë se 50,000 Lekë).
 - o **Kufizimet**
 - Kontrolli i shumës së përgjithshme nga i njëjti donator, në veçanti nëse disa donacione janë bërë në nivel qendror nga një degë e partisë;
 - Kufizimet (pragu i raportimit dhe deklarimit zbatohet si për kontributet në para ashtu edhe për ato në natyrë – *si të garantojmë respektimin e kësaj dispozite kur raportet e financimit të fushatës zgjedhore konsolidojnë llogaritë e selisë së partisë me ato të degëve?*)

c/ Financimi nga burimet e vetë partisë politike

- **Klasifikimi sipas zërave i të ardhurave nga burimet e vetë partisë**

Emër Mbiemër _____

Firma _____

Data _____



- ☐ Kuotat e anëtarësisë: shuma e përgjithshme dhe e detajuar sipas shumave të marra
- ☐ Botimet
- ☐ Shtypi i printuar
- ☐ Dhënia me qira
- **Klasifikimi i të ardhurave që merren nga burimet e vetë partisë për secilin zë të deklaruar sipas emrit të degës**
 - ☐ Zyrat Qendrore
 - ☐ Degët lokale
- **Përputhshmëria mes natyrës dhe shumës së të ardhurave të deklaruar dhe deklarimit bankar (bank statement) (mund të përdoret edhe termi “nxjerrje e llogarisë”)**

d/ Huatë/Kreditë

- Identiteti i huadhënësit/ve
- Shuma dhe data e huasë/ve (paraqitja e kontratës së kredisë / huasë).
- Data e shlyerjes e përcaktuar në kontratën e kredisë / huasë/ve (*problemi i huave të fshira— në rast dyshimi, e rëndësishme që të theksohet*)
- Normat e interesit (*llogaritet tek shpenzimet si një shpenzim zgjedhor?*)

Emër Mbiemër_____

Firma_____

Data_____



III. SHPENZIMET

A. PËRMBLEDHJE

Shuma e përgjithshme e raportuar							
Respektimi i kufirit të shpenzimit (Shuma e shpenzimeve nuk duhet të jetë më shumë se 5 herë më e madhe se shuma më e lartë që ka marrë një subjekt zgjedhor nga fondet publike për qëllime zgjedhore, në përputhje me nenin 88 të ligjit nr.10019, datë 19.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar)		Po / Jo					
Shpenzimet e kryera nga Zyra Qendrore e partisë							
	Shpenzimet zgjedhore të deklaruar në raportin e financimit të fushatës zgjedhore	Faturat e paraqitura	Faturat e Përgjithshme	Dokumente mbështetëse që mungojnë	Shpenzime të papaguara	Mospërputhje në lidhje me dokumentet e paraqitura nga furnitorët	Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit
Mitingjet/tubim e dhe aktivitete në fushatë							
Materialet promocionale							
Media							
Media Sociale							
Sondazhe							

Emër Mbiemër _____

Firma _____

Data _____



Botime/Publiki me							
Transporti							
Konsulenca							
Reklamime në natyrë							
Shpenzime zyre zgjedhore							
Shpenzime administrative							
Shpenzimet e bëra nga degët e partisë							
	Shpenzimet zgjedhore të deklaruar në raportin e financimit të fushatës zgjedhore	Faturat e paraqitura	Faturat e Përgjithshme	Dokumente mbështetëse që mungojnë	Shpenzime të papaguara	Mospërputhje në lidhje me dokumentet e paraqitura nga furnitorët	Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit
Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës							
Materialet promovuese							
Media							
Sondazhet e opinionit publik							
Botimet							
Transporti							
Konsulenca							

Emër Mbiemër _____

Firma _____

Data _____



Reklamat në ambientet e jashtme							
Administrative dhe të përgjithshme							
Shpenzimet zgjedhore							
Të gjitha shpenzimet zgjedhore të bëra janë paguar përmes një llogarie të veçantë							Po / Jo
Totali i shpenzimeve të bëra nga kandidatët e listave shumemërore							

Emër Mbiemër_____

Firma_____

Data_____



B. ANALIZA

a/ Respektimi i kufirit të shpenzimeve të fushatës (është çdo shpenzim që bën një parti ose kandidatët e saj për qëllime të fushatë zgjedhore): Për partitë politike **326.456.950** lekë ndërsa për kandidatët e pavarur **32.645.695** lekë → fokusohuni tek “fushatat e shumëfishta” të bëra në nivel qendror dhe degët e partisë në të gjithë vendin;

b/ Analiza e të gjithë shpenzimeve të deklaruar dhe klasifikuara sipas degës së partisë dhe kategorisë, në përputhje me modelin e raportit të financimit të fushatës zgjedhore.

- Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës (fokusohuni tek këto);

- o Shpenzime për vendin/ambjentin;
- o Shpenzimet e zbavitjes/argëtimit;
- o Shpenzimet e pajisjeve;
- o Shpenzimet për pijet;
- o Shpenzimet e reklamave/promocioneve;
- o Shpenzimet e Transportit;
- o Shpenzimet administrative;

- **Materialet promionale**
- **Media**
- **Media sociale**
- **Sondazhe**
- **Botimet/Publikimet**
- **Transporti**
- **Konsulenca**
- **Reklamime në natyrë**
- **Shpenzime zyre zgjedhore**
- **Shpenzime administrative**

KUJDES: Për secilën kategori të shpenzimeve, analizoni:

- Natyrën zgjedhore të shpenzimeve të llogaritura dhe të përfshira në raportin e financimit të fushatës zgjedhore;

Emër Mbiemër _____

Firma _____

Data _____



- Ekzistencës dhe/ose zbulimit të shpenzimeve të paligjshme (keqpërdorimi i burimeve publike / blerja e votës). Sidoqoftë, këto shpenzime, të paligjshme nga natyra, duhen llogaritur dhe këto shpenzime të llogaritet si tejkalim i kufirit të shpenzimeve.
- Shpenzimeve që janë bërë 6 (gjashtë) muaj para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve duhen llogaritur dhe këto shpenzime si tejkalim i kufirit të shpenzimeve.
- *Raportimi i shpenzimeve në natyrë. Duhet të ekzistojë një përputhshmëri me donacionet në natyrë.*

I. PËRFUNDIMI

A. SINTEZA

- o Përmbledhja e gjetjeve dhe përfundimeve
- o Lista e parregullsive të gjetura gjatë procesit të auditimit
- o Krahasoni me raportin e monitorimit të ekspertit financiarë?

B. PËRFUNDIMI

- o Çertifikimi/dhënia e opinionit pa rezervë
- o Çertifikimi me përmirësime / rezerva/opinionin me rezervë
- o Refuzimi për ta çertifikuar/refuzimi për të dhënë opinion

Opinionin pa rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë tregtare ABC (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 20XX, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, *(ose japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për)*, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 Dhjetor 20XX, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit dhe Kontabilitetit. Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në *[juridiksionin]*, dhe kemi përmbushur

Emër Mbiemër _____

Firma _____

Data _____



përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Opinionit me rezervë (kundërshtues/refuzues)

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë tregtare ABC (shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 20XX, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në seksionin e Bazës për Opinionin me Rezervë të raportit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, (ose japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për) pozicionin financiar të shoqërisë me datën 31 Dhjetor 20XX, dhe performancën financiare e flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin me rezervë

Inventarët e shoqërisë janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në shumën xxx. Drejtimi nuk i ka paraqitur inventarët me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme, por vetëm me kosto, çka përbën një devijim nga kërkesat e SNRF-ve. Regjistrat e shoqërisë tregojnë se nëse drejtimi do t'i kishte paraqitur inventarët me më të ultën midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme, një shumë prej xxx do të paraqitej si pakësim/rënie e vlerës së inventarëve për t'i çuar ato deri në vlerën e tyre neto të realizueshme. Për rrjedhojë, kostot e shitjes do të ishin rritur me xxx dhe tatimi mbi të ardhurat, të ardhurat neto dhe kapitali i aksionarëve do të ishin reduktuar respektivisht me xxx, xxx dhe xxx.

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit dhe Kontabilitetit. Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit të Përgjegjësisë të Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare (të zbatueshme në juridiksionin përkatës) dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë me rezervë.

Emër Mbiemër _____

Firma _____

Data _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

TABELA E FONDEVE TË PËRFITUARA NGA PARTIA/KOALICIONI/KANDIDATËT E LISTAVE
SHUMEMËRORE/KANDIDATËT E PAVARUR _____ PREJ PERSONAVE FIZI OSE JURIDIK VENDAS, PËR
ZGJEDHJET PËR KUVEND

Nr.	Përshkrimi i dhurimit	Vlera (lekë)	Nr. identitetit (ID, NIPT)	Data e dhurimit (dd/mm/vvvv)	Numri i llogarisë (Ku depozitohet dhurimi)
1					
2					
3					
4					
5					
6					
7					

Shënim: Për çdo dhuratë në sende ose shërbime, subjekti zgjedhor do të llogarisë dhe deklarojë kundërvlerën në lekë të sendeve ose shërbimeve duke u bazuar në indeksin mujor të çmimeve, të publikuara nga INSTAT. Për sendet ose shërbimet, vlera e të cilave nuk pasqyrohet në indeksin mujor të çmimeve, subjektet zgjedhore do t'i referohen çmimit të tregut në momentin e marrjes së dhurimit.

Shuma Totale e dhurimit _____ **Lekë**
Me shifër Me fjalë

Partia/Koalicioni/Kandidati i listave shumemërore/Kandidati i pavarur _____

Financieri _____
(emër, mbiemër, firmë)



Miratuar me Vendimin nr. __, datë __.__.20__, të Komisionit Rregullator



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

TABELA E BILANCIT TË ASETVE PËR PERIUDHËN NGA DEKRETIMI I DATËS SË ZGJEDHJEVE DERI DATËN E ZGJEDHJEVE

Nr.	Përshkrimi i dhurimit	Sasia (copë)	Datë blerje/dhurimi	Kosto (lekë)	Vlera (lekë)
1					
2					
3					
4					
5					
6					
7					

Shuma Totale e dhurimit _____ **Lekë**
 Me shifër _____ Me fjalë _____

FINANCIERI _____

Emër, Mbiemër, Firmë



Miratuar me Vendimin nr. __, datë __.__.20__, të Komisionit Rregullator